

URDHËR
Nr.177/1, datë 16.3.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES NË ZONAT URBANE

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane pas orës 18:00, me përjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.
2. Ndalimin e lëvizjes së këmbësorëve pensionist në zonat urbane deri në një urdhër të dytë me përjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu